



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:149029  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05472146

**C.nr.2330/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen kontestimore të paditësve: B.S, M.S, N.S, A.S, SH.S të gjithë nga fshati N, Komuna e Pejës, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. B.A nga Peja, kundër të paditurës: K.S.P në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera kontestit 1.000 €, jashtë seancës me dt. 19.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET E TËRHEQUR** padia e paditësit B.S, M.S, N.S, A.S, SH.S të gjithë nga fshati N, Komuna e Pejës, kundër të paditurës K.S.P në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera kontestit 5.000€.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kanë ushtruar padi me dt.07.07.2023, kundër të paditurës, me bazë juridike Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera kontestit 5.000 €.

I autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 07.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë ndaj të paditurës, për shkak se me të njëjtën kanë arritur ujdi jashtëgjyqësore, andaj kërkojmë nga gjykata që të lejoj tërheqjen e padisë

Sipas dispozitës së nenit 261.1, LPK-së, e cila parashikon se paditësi mund ta tërheq padinë, pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin, në të cilën i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjersa paragrafi 2, parashikon se padia mund të tërhiqet edhe më vonë gjerë në përfundim të shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda afatit prej 7 dite, nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 2, 3, dhe 4 e lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:149029  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05472146

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.2330/23 dt. 19.03.2024**

**Gjyqtari**  
Besnik Shala

**KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa,  
Konform nenit 261 pra.4 të LPK-së.